

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“AMITIÉ” SHPK**

Ortakët themelues si më poshtë:

- **zpj. Alda Mehmetaj**, shtetase shqiptare, e datëlindjes 31.12.1995, lindur në Pukë dhe banuese në Durrës, rruga “Shkodra”, shtëi private, mbajtëse e letërnjoftimit nr. 034614448 dhe numër personal J56231058K;
- **zpj. Ariola Likometa**, shtetase shqiptare, e datëlindjes 22.03.1993, lindur në Memaliaj dhe banuese në Durrës, Shkozët, lagjja 14, rruga “Durrësi në Sheku”, mbajtëse e letërnjoftimit nr. 036660262 dhe numër personal J35322078B;

bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, sot më datë 12.07.2021, hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

**NENI 1**  
**Emri**

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “AMITIÉ”.

Ndryshimi i emërtimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 2**  
**Forma**

Shoqëria tregtare “AMITIÉ”, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

**NENI 3**  
**Zyra Qendrore**

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “AMITIÉ” SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën rruga “K.Kazanxhi”, nr. 16, nr. pasurie 2/347-N2, Durrës, Shqipëri.

3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 4**  
**Objekti i Veprimtarisë**

Shoqëria ka si objekt aktiviteti Atelier (Rrobaqezi/Stilim) prodhim dhe shitje veshjesh, aksesorësh mode dhe tekstilesh, me shumicë dhe pakicë; organizim eventesh mode.

**NENI 5**  
**Kohëzgjatja**

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

**NENI 6**  
**Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit**

Shoqëria tregtare “AMITIÉ” SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

**NENI 7**  
**Përgjegjësia e Ortakëve**

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë "AMITIÉ" SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

**NENI 8**  
**Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat**

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "AMITIÉ" SHPK është 100,000 (njëqind mijë) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga të gjithë ortakët.

8.2 Ortakët kanë kontribuar në krijimin e kapitalit të shoqërisë dhe zoterojnë kuotat e tyre në këtë mënyrë:

- Ortaku Alda Mehmetaj, zoteron 1 (një) kuotë të kapitalit me vlerë 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë, e cila përfaqëson një pjesëmarrje prej 50 % (pesëdhjetë përqind) në kapitalin e shoqërisë;
- Ortaku Ariola Likometa, zoteron 1 (një) kuotë të kapitalit me vlerë 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë, e cila përfaqëson një pjesëmarrje prej 50 % (pesëdhjetë përqind) në kapitalin e shoqërisë.

**NENI 9**  
**Organet e Shoqërisë**

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

**NENI 10**  
**Administratori**

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 2 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administrator i Shoqërisë është ortaku znj. Alda Mehmetaj.

**NENI 11**  
**Sekreti tregtar**

Ortakët, administratori dhe punëmarrësit e shoqërisë "AMITIÉ" SHPK përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.

**NENI 12**

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjdhje Gjykatës kompetente.


**Ky Akt Themelimi përpilohet në 3 (tre) origjinale në gjuhën shqipe.**

**ORTAKËT THEMELUES**

**ALDA MEHMETAJ**

  
Alda Mehmetaj

**ARIOLA LIKOMETA**

  
Ariola Likometa  
2